



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURRENCËS**  
**DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE**

**NJOFTIM**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë Vum, a.s. nga shoqëria Elkem Carbon AS.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 17 Prot., i AK, datë 06.01.2023 “Njoftim përqendrimi”, nëpërmjet të cilës është njoftuar transaksioni i propozuar mbi marrjen e kontrollit të shoqërisë Vum, a.s., nga shoqëria Elkem Carbon AS.

Referuar dokumentit “Marrëveshje blerje aksionesh”, palët janë:

**Blerësi : Elkem Carbon AS** është një shoqëri e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë, me veprimtari të saj: furnizimin me produkte dhe shërbime me bazë karboni për industrinë e ferroaliazheve, silikonit dhe aluminit. Elkem Carbon AS është një shoqëri brenda divizionit “Zgjidhjet e Karbonit” të shoqërisë Elkem ASA, i cili zotërohet plotësisht nga kjo e fundit.

**Shitësi: Delta Consult a.s.** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Sllovakisë.

**Target: Vum, a.s.**, është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Sllovakisë, me objekt: blerjen e mallrave për qëllime të rishitjes së tyre të operatorëve të tjerë tregtarë, ndërmjetësimi i biznesit në kuadër të licencës së tregtisë së lirë, mbajtja e kontabilitetit etj., Vum, a.s., është një shoqëri aktive në tregun e produkteve të karbonit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**